




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	25.03.2015	PRISHTINE
REFERENC-Ë:	DPK-DPKPP- 03-03/494/15	
PËR/ZA/TO:	z. Fadil KRASNIQI Shef i Prokurimit Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut	
CC:	z. Hysen SADRIU Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut	
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve "	

Inderuari z. Krasniqi,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin "Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve" me numër prokurimi 71700-015-002-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve " me numër prokurimi 71700-015-002-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m i

Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës së Prokurimit ka përgatitur Njoftimin për Konratë me titull " Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve" me numër prokurimi 71700-015-002-221, i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.12.02.2015. Për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti kontraktues ka paraparë procedurën e hapur, Konratë Publike Kornizë të llojit shërbime me vlerë të mesme të kontratës.

Agjencia kundër Korruptionit duke vepruar sipas detyrës zyrtare e ka identifikuar ketë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të dokumenteve të Dosjes së këtij Tenderi, Agjencia ka hasur në disa kritere të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Përfaqësuesi i Agjencisë Kundër Korruptionit ka marr pjesë në vëzhgimin e punës së Komisionit vlerësues rrëth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve dhe pasi ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet përkatëse për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej **15** Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë konratë i kanë dorëzuar **6** OE. Duke u bazuar në Raportin e hapjes së Tenderit janë ofruar çmimet si në vijim: Operatori ekonomik N.T.SH. Sfishta ka ofruar çmimin e përgjithshëm prej **46.913.43 €**, Operatori ekonomik NPSH. AGS ka ofruar çmimin prej **24.434.81 €**, Operatori ekonomik NTP. Miri ka ofruar çmimin prej **28.778,74 €** Operatori ekonomik Dragusha ka ofruar çmimin prej **16.523,40 €**, Operatori NTP Bosch ka ofruar çmimin prej **14.798,60 €** dhe OE Adi ka ofruar çmimin prej **11.151.80 €**.

Komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar të gjitha ofertat e Operatorëve Ekonomik konkurrues, ka konstatuar dhe ardhur në përfundimet si në vijim: Sipas Komisionit vlerësues **6** ofertat e pranuara për ketë tender i plotësojnë kriteret minimale të Dosjes së Tenderit dhe kualifikohen në vlerësimin e mëtutjeshëm. Mirëpo tek ofertat financiare të këtyre Tenderuesve, Komisioni vlerësues ka vërejtur se në shumë pozicione të listave të çmimeve, janë ofruar çmime jo-normalisht të ulëta.

Zyrtari i Prokurimit i ka drejtuar letrën standarde për informata lidhur me tenderët jo-normalisht të ulët Operatorit ekonomik i cili është rekomanduar për dhënie të kontratës dhe ka pranuar përgjigjen me shkrim nga i njëjti i cili i ka konfirmuar se qëndron prapa çmimeve të dhëna në propozimin financier. Lidhur me këtë Komisioni vlerësues i ka rekomanduar zyrtarit përgjegjës të prokurimit që Operatori ekonomik i renditur me nr. 3 me çmim prej **28.778,74 €** në Raportin e vlerësimit të tenderëve të shpallet fitues dhe me të lidhet kontrata.

Agjencia pasi ka shqyrtuar me kujdes letrën standarde për informata lidhur me tenderët jo-normalisht të ulët e cila është përgatitur nga ana e Zyrتari të Prokurimit, vëren se e njëjtë ka mangësi, pasi në të vetëm është theksuar se a qëndron Operatori ekonomik prapa çmime të ofruara pa të dhëna tjera lidhur me pozicionet e çmimeve jo-normalisht të ulëta të cilat i ka vërejtur Komisioni vlerësues. Gjithashtu edhe përgjigjja apo konfirmimi të cilin e ka dorëzuar Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i mangët jo i arsyetuar mirë, pasi që në të theksohet vetëm se qëndron parapa çmimeve tjera pa dhënë arsyen e tijerë për çmimet e ulëta të ofruara në disa pozicione.

Në Njoftimin për Kontratë i cili është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia vëren se si kriteri për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kritere i ka vendosur 1. Servisimin e rregullt në bazë të km të kaluara të cilin e ka peshuar me 60 %, 2. Pjesët dhe metalet të cilit i ka caktuar peshë prej 20 %, 3. dhe, 4. Ngjyrosja e pjesëve te karrocerisë të cilat gjithashtu i ka caktuar peshë prej 10 %, kritere këto të cilat nuk parashihen askund në Legjislacionin e Prokurimit Publik. Ndërsa në Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur për këtë kontratë tek Aneksi 6. Tek pjesa e Kritereve për dhënie të kontratës, Autoriteti kontraktues ka paraparë çmimin si kategori ndërsa tek përshkrimi i kritereve ka paraparë Servisimin e rregullt në bazë të km të kaluara të cilin e ka peshuar me 60 %. Pjesët dhe metalet të cilit i ka caktuar peshë prej 20 %, Riparimet, dhe pjesët e karrocerisë të cilin e ka peshuar me 10%, Ngjyrosja e pjesëve të karrocerisë të cilat gjithashtu i ka caktuar peshë prej 10 %. Nga të dhënat si më lartë mund të konstatohet shumë qartë se ekziston mospërputhje në mes kritereve që janë caktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, pasi që në Njoftimin për Kontratë si kriteri për dhënie Autoriteti Kontraktues nuk ka caktuar as kriterin çmimi më i ulët e as Kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm dhe paraprakisht nuk mund të kuptohet qartë se me çfarë kriteri matës do të bëhet vlerësimi i tenderëve nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Nga e tërë kjo mund të nënkuftohet se Autoriteti Kontraktues si kriteri për dhënie të kontratës ka caktuar Tenderin ekonomikisht më të favorshëm, ndërsa si nën kritere i ka caktuar katër kategoritë ku parashihen pjesë të ndryshme të automjeteve dhe në kuadër të katër kategorive ka përcaktuar çmimin më të ulët për secilën kategorinë e pjesëve. Operatorët ekonomik të cilët kanë ofruar çmimet më të ulëta për secilën kategorinë kanë fituar pikët maksimale dhe nga kjo konstatohet se qëllimi i Autoritetit kontraktues ka qenë që të caktoj si kriteri matës vetëm çmimin më të ulët.

Sipas aneksit 6 të Dosjes së Tenderit tek pjesa e kritereve për dhënie të kontratës, nëse Autoriteti Kontraktues ka caktuar si kriteri matës vetëm çmimin më të ulët atëherë sipas pikës 2 të këtij aneksi i njëjti nuk ka pasur të drejtë ta përdor formulën për peshimin e pikëve.

Sipas këtij Ligji si kritere për dhënie të kontratës parashihen të jenë dy çmimi më i ulët dhe Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, tek i cili përveç çmimit duhet të parashihen edhe nën kritere tjera si cilësia, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike e jo të jetë vetëm çmimi më i ulët si kriter matës. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka për synim që ta gjej çmimin më të ulët brenda ofertave, atëherë duhet që si kriter për dhënie të kontratës ta caktoj çmimin më të ulët e jo që për brenda kriterit Tenderi ekonomikisht më i favorshëm ta caktoj si nën kriter vetëm çmimin më të ulët.

Në lidhje me nën kriteret **1, 2, 3 dhe 4** Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kritere të tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues, andaj konsiderojmë se nën kriteret e lartë cekura të cilat janë vendosur nga ana e Autoritetit bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimit Publik. Sipas këtij Ligji si kritere për dhënie të kontratës parashihen të jenë dy çmimi më i ulët dhe Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, tek i cili përveç çmimit duhet të parashihen edhe nën kritere tjera si cilësia, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike etj. Në rastet kur Autoriteti kontraktues përcaktohet që ta përdor si kriter për dhënie të kontratës, kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm atëherë përveç, çmimit duhet të caktojë edhe nën kritere tjera, përkatësisht ta ndaj çmimin edhe me nën kritere tjera.

Pas analizimit të Specifikimeve teknike dhe listave të çmimeve të ofruara nga Tenderuesi i cili është rekomanduar për dhënie të kontratës, janë vërejtur çmimet jo-normalisht të ulëta. Në pjesën a) ku është paraparë Servisimi i rregullt janë ofruar çmimet si në vijim: vaji i motorit 2.95 €, filteri i vajit 1.10 €, filteri i naftës 1.10 €, filteri ajrit 1.10 €, filteri i klimës 1.30 €, vaj hidrauliku 0.30 €, vaj i ndërruesit të shpejtësive 0.45 €, Glicerina (UK-2) 0.10€. Lidhur me këtë pjesë Agjencia vëren se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime shumë më ulëta në krahasim me Tenderuesit tjerë në mënyrë që të fitoj maksimumin e pikëve prej 60% sa ka qenë për këtë pjesë. Ndërsa tek pjesa **b, c** dhe **d** ku ka pasur më pak pikë i njëjtë Operator ka ofruar çmime më të larta në krahasim me disa Operator tjerë ekonomik dhe pikërisht një formulim i tillë i kritereve për dhënie mund të përbëj një rrezik shumë të lartë që për pjesët tjera ku ka pas më pak pikë, Autoriteti kontraktues të paguaj çmime shumë më të larta sesa çmimet reale të tregut.

Kjo ndërlidhet me mos formulimin e drejtë të nën kritereve për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues, pasi që pikërisht përdorimi i nën kritereve të tillë ju mundëson Operatorëve ekonomik që ofrojnë çmime shumë të larta dhe në këtë mënyrë rrezikon që të dëmtohet në thelb buxheti i Autoritetit kontraktues.



Në pjesën b, c dhe d ku janë paraparë shumë pjesë janë ofruar çmimet si në vijim: Molleza për një llojitet të automjetit është ofruar me çmim prej 10 €, ndërsa për shumicën e automjetetve janë ofruar çmime prej 35 € deri në 58 €. Disku i mramë për një lloj të automjetit është ofruar me çmim prej vetëm 1 €, ndërsa për shumicën e automjetetve tjera prej 10 € deri në 65€, Cilindri i kvaqilles është ofruar me çmim prej 1 € për një lloj të automjetit, ndërsa për shumicën e automjetetve çmimi prej 95 € deri në 145 €, Dhemzori (zamajtsi) është ofruar me çmim nga 5 € deri në 269.00 €, Goma e verës është ofruar me çmim prej 60 € deri në 128 € dhe pikërisht këto lëvizje të mëdha në çmime për disa automjete mund të jenë një rezik shume i madh që Autoriteti kontraktues për të njëjtat pjesë të paguaj çmime të ndryshme.

Autoriteti kontraktues duhet që çdo herë të kujdeset që ti përdor në mënyrë sa më ekonomike fondet publike duke paguar çmime reale konform me çmimet e tregut në mënyrë që të mos ketë keqpërdorim të parasë publike.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin **27** Dosja e tenderit, Nenin **52** Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratë, Nenin **61** Tenderët Jo-Normalisht të Ulët të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L.-042 dhe nenin **25** Kriteret e dhënies së kontratës e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tillë, nuk duhet të lejohen në aktivitete të Prokurimit, andaj Agjencia kundër Korruptionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i mos i përsëris praktikat e tillë në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me Respekt !